



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 1.11.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Agim Aliu, dhe Jelena Bontiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Muhamed Shehu, Kosova Sot; Pranvera Musa, Kosovapress; Valmira Saraçi dhe Petrit Daku, KTV; Gramoz Paçarada, KDI; Sanije Berisha, OSBE; Burim Tahiri, IAP; Artan Murati, KDI; Rinor Beka dhe Shefki Kastrati, NDI; Naim Jaha, Grupi Parlamentar ‘Vetëvendosje’; Besim Morina dhe Valon Kurtaj, Akademia e Drejtësisë.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi raportit vjetor i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë;
5. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke zhvendosurnjë pikë të ndryshme me të parën, në lidhje me shqyrtimin e shkresës të dërguar nga Grupi Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje nr. 06/205/DO-154 dt. 30.10.2017.*

## 2. Shqyrtimi i lëndës për kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe ftoi z. Konjufca që të marrë fjalën para anëtarëve të Komisionit.

**GlaukKonjufca,** paraqiti shkresën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që ka të bëjë me hapësirat e këtij grupi parlamentar në ndërtesën e Kuvendit. Konjufca sqaroi se ky grup parlamentar funksionon në një zyrë me hapësirë të vogël, e cila i ka 6 ulëse, ndërsa shtoi se bazuar në praktikën e mëhershme parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje duhet të gëzojë të drejtat e tyre për akomodim në hapësirë më të madhe në këtë ndërtesë, krahasuar me grupet tjera parlamentare sipas Rregullores së Kuvendit. Po ashtu, ai kërkoi interpretimin e Rregullores së Kuvendit.

**Hajdar Beqa,** tha se konsideroj që kërkesa është e drejtë që secili grup parlamentar të ketë hapësirë për të punuar dhe vepruar duke iu referuar vitit 2008, Kuvendi ka pasur hapësirë më vogël për të punuar sepse kanë qenë disa ministri që kanë funksionuar në ndërtesën e Kuvendit. Beqa shtoi se nuk është kompetencë e komisionit për të shqyrtuar këtë lëndë, por është kompetencë e kryesisë që të urdhërojë administratën për të krijuar kushte më të përshtatshme të punës grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, brenda një jave, që të zgjidhet ky problem.

**Kryetarja,** tha se Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes kërkon që të interpretohet Rregullorja e Kuvendit dhe njëkohësisht të bëhet zbatimi i saj duke u bazuar në praktikën e mëhershme parlamentare.

**Shkumbin Demaliaj,** theksoi se koalicioni PAN në zgjedhje parlamentare ka dalë grupi më i madh parlamentar, mirëpo, për punë operationale i kemi ndarë grupet parlamentare. Demaliaj, tha se e përkrah që secilit grup parlamentar, por edhe secilit deputet ti krijohen kushte për të punuar në hapësirat e Kuvendit të Kosovës.

**Arben Gashi,** tha se sa i përket shkresës së Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Komisioni nuk mund të merret me këtë çështje sepse nuk është në fushëveprim të Komisionit dhe nuk kemi ndonjë bazë juridike të fortë mbi të cilën mund të japim interpretim. Ndërsa, si deklaram paska një praktikë të mëhershme parlamentare. Gashi propozoi që si Komision t'i kërkojmë Kryesisë që të zbatohet neni 15, pika 13 e Rregullores së Kuvendit.

**Bilall Sherifi,** tha se më mirë t'i japim një zgjidhje pragmatike sesa praktike sepse rregullorja thotë që Grupit Parlamentar më të madh ti krijohet hapësirë më e madhe. Mendoj t'i tejkalojmë këto simbolika apo praktika dhe të bëjmë një zgjidhje kompromisi që të ecim përpara.

**Korab Sejdiu**, theksoi se neni 20, pika 6 e Rregullores së Kuvendit është qartë e shkruar dhe kjo çështje nuk ka të bëjë me interpretim por me mungesë zbatimi. Sejdiu propozoi që të ngarkohet sekretari i Kuvendit që të zbatojë Rregulloren e Kuvendit dhe të vendoset secili grup parlamentar duke e zbatuar Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që t’iu sigurohenhapësirat e nevojshme proporcionalisht.

**Sami Kurteshi**,propozoi që të kërkojë nga kryesia të autorizojë sekretarin e Kuvendit sipas normave ligjore që janë në rregullore dhe të praktikës së konsoliduar deri më tani, që të ndërmarrë veprimin për akomodimin e grupit parlamentar.

*Pas diskutimeve të gjera, kryetarja konstatoi se anëtarët e Komisionit njëzëri vendosën që Komisioni në lidhje me këtë çështje të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit të veprojë në pajtim me nenet 15.13 dhe 20.6 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të marrë në konsideratë praktikën e mëhershme për ndarje të zyrave për akomodimin e grupeve parlamentare.*

### **3. Shqyrtimi raportit vjetor i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2016;**

**Kryetarja**, ftoi drejtorin e Institutit Gjyqësor të Kosovës që të paraqesë raportin e punës për vitin 2016.

**Valon Kurtaj**,tha se Akademia e Drejtësisë në mandatin e vet është marrë me trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por njëkohësisht është marrë edhe me publikime të ndryshme shkencore nga sfera juridike me ç’rast janë publikuar module trajnuese, Doracak për Trajnimin Praktik në Programin e Trajnimit Fillestar, revista shkencore ‘OpinioJuris’.

Po ashtu, është marrë me organizimin e programit të trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët janë aktualë në sistem, por njëkohësisht edhe për stafin administrativ dhe stafin mbështetës. Gjithashtu Akademia ka organizuar trajnimin fillestar për prokurorë, të cilët janë inkuadruar në kuadër të sistemit prokurorial të Kosovës si prokurorë të rinj.

Gjatë vitit 2016, kanë filluar përgatitjet për kurrikulën trajnuese, trajnimet fillestare, së pari për prokurorët e emëruar e më pas për gjyqtarët e sapoemëruar.

**Albulena Haxhiu, kryetare**, tha se pati debat goxha të gjatë në kohën kur është sjellë në Kuvend pakoja ligjore për sistemin e drejtësisë, me theks të veçantë për trajnimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, ku më parë ka qenë të ndjekësh trajnimin dhe më pas të dekretohesh, ndërsa tani është e kundërta; dekretohesh dhe më pas e ndjek trajnimin fillestar. Ne si grup parlamentar nuk e patëm përkrahur këtë, madje kemi bërë përpjekjepër ta ndryshuar propozimin e Ministrisë së Drejtësisë në atë kohë, por që nuk kemi arritur për shkak të mbivotimeve të shumicës.

Haxhiu pyetise sa ka paraqitur vështirësi ky ndryshim, që gjyqtarët dhe prokurorët të dekretohen dhe më pas të ndjekin trajnimet fillestare në Akademi të Drejtësisë, pasi jeni transformuar në

Akademi të Drejtësisë, a keni kapacitete, staf të nevojshëm si dhe mbështetje buxhetore për t'i kryer përgjegjësitë që i keni me ligjin në fuqi dhe po ashtu, cili është plani për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë që janë dekretuar së fundi, në programin për trajnues ?

**Besim Morina**, theksoi se fillimisht kemi hasë pengesë në planifikim të punës sepse nuk e kemi njohur dinamikën e punës të procedurave të rekrutimit, që i ka zhvilluar Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, ku ne nuk kemi marrë pjesë. Po ashtu, kemi pasur problem edhe tek buxheti për faktin se buxheti i cili ka qenë i dedikuar për trajnime fillestare nuk e kemi shpenzuar sepse trajnimet nuk kanë filluar. Numri i prokurorëve që po ndjekin trajnimin fillestar është 17, të cilët në dhjetor të vitit 2016, ndërsa numri i gjyqtarëve të sapoemëruar është 49. Kjo po paraqet një problem në aspektin e buxhetit, sepse është një numër i madh, që të njëjtën kohë po vijnë trajnimin në programin fillestar, prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët në total e kalojnë numrin 80, që janë çdo ditë në Akademi të Drejtësisë. Edhe pse Instituti Gjyqësor i Kosovës është transformuar në Akademi të Drejtësisë, duke pohuar se e vështirëson shumë punën e Akademisë, për të përballuar këtë kapacitet që kemi, numri i stafit nuk është rritur, edhe pse tanimë Akademia e Drejtësisë ka edhe kompetenca shtesë, në bazë të ligjit, nuk i përmbush kërkesat lidhur me mandatin e Akademisë së Drejtësisë. Programi për trajnime të vazhdueshme ka përfshirë trajnimin dhe aktivitetet tjera për gjyqtarë dhe prokurorë, gjithmonë në përmbushje të nevojave për një sistem gjyqësor dhe prokurorial profesional, etik, të paanshëm dhe të pavarur.

Më tej, sqaroi se edhe trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të integruar, të cilët do të inkuadrohen në sistem të drejtësisë, duke pohuar se para dy vitesh, si institucion, kemi përgatitur një program orientues trajnimi, i cili është bërë nga një grup punues, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, të mbështetur nga Ambasada Amerikane dhe GIZ-i gjerman. Ky grup punues i ka identifikuar çështjet kryesore, që do të përfshihen në një program hyrës, me qëllim që të jemi afër gjyqtarëve dhe prokurorëve, që do të integrohen në sistemin gjyqësor.

**Korab Sejdiu**, tha se shpresoj që programi trajnues është i bazuar në nevojat e personave të cilët inkuadrohen në sistemin e drejtësisë. Sejdiu pyeti se sa kanë njohuri dhe kapacitet të zbatojnë procedurat në kontekst penal, civil dhe atë administrativ sepse pasojat janë të jashtëzakonshme për palët të cilat paraqiten pranë këtyre organeve, duket pohuar se po luhet pingpong me palët duke krijuar lëndë shtesë. Prej një lënde të vetme, ku mund të vendoset herën e parë dhe për më tepër që gjyqtarët asnjëherë nuk vendosin për dëmin edhe pse kanë të drejtë dhe nga një lëndë krijohen dy lëndë. Gjyqtarët duke i shpërfill procedurën dhe diskrecionet që i kanë duke i përdorur në mënyrë arbitrare, po krijojnë lëndë shtesë në një sistem që është i stërngarkuar, ndaj procedura duhet të mësohet patjetër gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm. Pikë kyçe e trajnimit duhet të jetë edhe programi për të drejtat dhe liritë e njeriut, veçanërisht në procedurë penale por edhe në procedurat tjera sepse vazhdimisht institucionet por edhe gjyqësori bëjnë shkelje drastike të drejtave të njeriut gjatë procedurës.

Sejdiu theksoi se sikur qytetarët të kishin qasje në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, të cilët janë palë në procedurë, besoj që do të gjenin mbështetje nga kjo Gjykatë. Kjo do të kishte

pasoja për buxhetin e shtetit sepse të gjitha palëve që po iu shkelet e drejta po kërkojnë kompensim dhe vazhdimisht po krijohet barrë për buxhetin e shtetit. Po ashtu, shqetësuese është edhe çështja e shkrimit dhe hartimit të vendimeve, ku arsyetimi i vendimit gjyqësor është obligim ligjor dhe kushtetues dhe nëse bëjmë një analizë të aktvendimeve apo aktgjykimeve, lë shumë për të dëshiruar, ndaj duhet shtuar shumë kujdes edhe trajnimit për hartimine vendimeve.

**Kryetarja**, paraqiti shqetësimin në qasjen diskriminuese nga ana e gjyqtarëve më të vjetër, që iu bëhet vazhdate apo grave në rastet e trashëgimisë, amësisë apo edhe divorceve dhe kërkoi që në këtë drejtim ta kenë parasysh këtë çështje.

**Glauk Konjufca**, theksoi se nga ajo çfarë deklarohet, sistemi i drejtësisë nuk qëndron mirë, duke pohuar se hallka më e dobët e sistemit të drejtësisë janë prokurorët, ndërsa gjyqtarët pak më mirë. Konjufca potencoi se në çdo raport ndërkombëtar që nga Raporti i Progresit, thembra e Akilit në sistemin tonë gjyqësor është mbrojtja e dëshmitarëve, pra është shumë keq dhe unë pres nga ju që ti identifikoni problemet dhe ti listoni rastet të cilat ju duhet të përmirësohen, në mënyrë që të ketë rezultate.

**Hajdar Beqa**, tha se raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, është një raport i pasqyruar drejt në raport me punën që kanë kryer. Në bazë të raportit final të auditimit të pasqyrave financiare të IGJK-së për vitin 2015, del që ju i keni zbatuar të gjitha rekomandimet e auditorit në lidhje me çështjet e gjetura gjë që është për tu vlerësuar.

Beqa pyeti se a është stafi i mjaftueshëm dhe profesional njëkohësisht për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të dekretuar, të cilët ndjekin trajnimet në Akademi sepse Akademia duhet të jetë në nivel më lartë se gjyqtarët dhe prokurorët.

**Shkumbin Demaliaj**, pyeti se kush janë trajnuesit të cilët i trajnojnë prokurorët dhe gjyqtarët e dekretuar dhe cila është cilësia e tyre dhe po ashtu a janë vendorë apo ndërkombëtarë?

**Kryetarja**, pyeti se a ka pasur ndonjë rast që dikush nga prokurorët apo gjyqtarët nuk e kanë kaluar provimin dhe cili ka qenë roli juaj?

**Bilall Sherifi**, tha se e shpreh shqetësimin në ecjen shumë të ngadaltë në drejtim të standardit të drejtësisë jo vetëm tek gjyqtarët dhe prokurorët por edhe tek avokatët sepse këto janë pjesë të sistemit të drejtësisë që nuk bëjnë njëra pa tjetrën.

Sherifi potencoi faktin se prokurori është shumë i rëndësishëm në sistemin e drejtësisë dhe të bëhet shumë kujdes tek ngritja e tyre profesionale, mbi të gjitha kredibiliteti i tyre njerëzor dhe moral sepse prokurori në sistemin tonë mund të shkatërrojë jetë njerëzish, sidomos tek ata persona që kanë edhe jetë publike dhe deri sa të marrë pafajësinë, opinionin ynë e gjykon dhe e shpall fajtor në shumë raste. Prandaj, ju inkurajoj të insistoni në ngritjen e cilësisë sepse mekanizmat janë krijuar, por ato duhet të përmbushen dhe jo të shkruajmë disa raportesepse askujt nuk i hyn në punë nëse gjendja në terren nuk ka ndryshuar.

**Besim Morina**, tha se puna e parë që e bën Akademia e Drejtësisë, është vlerësimi i nevojave në sistem për trajnime dhe ky është i gjithë bazamenti mbi të cilin ndërtohet i gjithë programi i trajnimeve, që synohet të zbatohet në secilin vit vijues. Ky proces është shumë kompleks dhe përfshin në vetvete një numër të madh të aktorëve dhe mekanizma nga të cilët ne marrim informatat e nevojshme se cilat janë shqetësimet, problemet, qofshin ato të praktikës gjyqësore, ligjore apo nga sfera të ndryshme. I gjithë ky informacion kalon në disa filtra, që kryesisht janë gjyqtarë, prokurorë por edhe profesorë universitarë apo edhe ekspertë të fushës që brenda gjyqësorit nuk ka ekspertizë të tillë dhe duke u bazuar tek kjo ne bëjmë një program që është i arsyeshëm dhe i mundshëm të zbatohet për vitin në vijim. Edhe para hyrjes në fuqi të Ligjit për Akademi të Drejtësisë, trajnimi i vazhdueshëm për dallim nga trajnimet fillestare ka qenë mbi baza vullnetare, që secili gjyqtarë dhe prokurorë mund të aplikojë dhe të marrë pjesë në trajnimet që ata kanë nevojë apo konsiderojnë të zhvillojnë shkathësitë apo kapacitetet e veta profesionale. Jo të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët marrin pjesë në trajnime dhe kjo mbase mund të ndikojë në performancën e tyre. Trajnime që janë pjesë në programin trajnues në Akademi të Drejtësisë i përfshin të dyja aspektet edhe materiale dhe procedurale i bazuar në nevojat reale që paraqiten. Ndërsa në fushën administrative për vitin 2016, ne kemi organizuar 7 trajnime dhe të njëjtën kohë i kemi organizuar edhe 7 trajnime për të drejtat e njeriut.

Ndërkaq, për shkrime dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, kemi organizuar një trajnim por si nevojë edhe ne e kemi parë që është shumë e domosdoshme dhe për këtë qëllim gjatë këtij viti ne kemi nxjerrë edhe një doracak që ata të zhvillojnë shkathësitë e tyre në arsyetimin e vendimeve.

Morina theksoi se tryeza për mbrojtjen e dëshmitarëve ka qenë më specifike dhe për këtë arsye është paraqitur veçanërisht në raport dhe ajo çfarë është thënë ne e kemi evidentuar por nuk do të thotë që qëndron çështja në terren, siç është diskutuar, por ne nuk kemi pas mundësi që ta nxjerrim në raport diçka që nuk është trajtuar. Lidhur me efektin e trajnimeve ne duhet të shohim se çfarë kemi bërë, por kjo është sfidë në vete sepse nuk kemi mundësi që të përcjellim gjyqtarët apo prokurorët në rastet që ata kanë sepse statistikat ne i marrim si numra prej Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial dhe nuk mund t'i marrim sipas fushave dhe sipas emrave të gjyqtarëve.

Sa i përket stafit ai është kualifikuar për të kryer punën që e kryen Akademia e Drejtësisë, por ata nuk angazhohen në mbajtjen e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë. Trajnuesit janë gjyqtarë dhe prokurorë që janë në sistemin e drejtësisë, ekspertë të fushave, profesorë universitarë, por ka edhe trajnues ndërkombëtarë nga projektet që mund të na mbështesin donatorët. Sipas ligjit për Akademi të Drejtësisë, në trajnimin fillestar prokurorët dhe gjyqtarët duhet të ndjekin trajnimin 12 mujordhe nëse Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial vlerësojnë se nuk kanë arriturtë marrin raste pas periudhës 12 mujore, sipas ligjit ata mund të kthehen në trajnim, por ende nuk ka ndodh sepse jemi në përfundim të gjeneratës së parë.

**Kryetarja**, kërkoi që të dërgohet një rekomandim në lidhje me sfidat me të cilat përballet Akademia e Drejtësisë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash 5 për dhe 2 abstenime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet Raporti i Punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2016.

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-147 për ndryshimindheplotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 dhe tha që punën që e ka bërë gjykata tani e bën noteria me kryerjen e të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore, mirëpo, mendoj se kjo paraqet problem tek qytetarët që nuk qëndrojnë mirë financiarisht. Më tej znj. Haxhiu kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk pati diskutime , kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash,(3 për, 1 kundër dhe 2 abstenime) vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore.

#### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë;**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim në parim për Projektligjin nr. 06/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, duke thënë se ka një sërë problemesh që janë me ligjin aktual dhe që ka dështuar. Qeveria ta përfshinë këtë projektligj si p.sh. heqja dorë nga trashëgimia, e cila është lënë ashtu siç është aktualisht.

Znj. Haxhiu potencoi se ndryshimet aktuale janë teknike dhe për secilin prej këtyre problemeve që nuk janë përfshi në Projektligj do të bëjë amendamente, por po ashtu do ti deklarojë edhe në mbledhje të seancës plenare se cilat janë propozimet e Lëvizjes Vetëvendosje në raport me këtë projektligj.

Më tej, znj. Haxhiu kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje.

**Bilall Sherifi,** u pajtua me vërejtjet që u paraqitën dhe tha se do të kontribuojmë në amendamentimin të këtij Projektligji.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, **4 për dhe 2 kundër**, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë.

## **6. Të ndryshme.**

### **A. Propozim për ndërrimin e kryesuesit të Grupit Punues për Rregulloren e Kuvendit**

*Pas diskutimeve, Albulena Haxhiu, kryetare, konstatoi se me propozim të z. Shkumbin Demaliaj, Komisioni vendosi që me **4** vota për **1** kundër dhe **2** abstenime, kryesues i Grupit të Punës për Rregulloren e Kuvendit të jetë z. Hajdar Beqa në vend të z. Agim Aliu.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**